



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-5719 /2024

Klinë, datë 20/02 /2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 04.06.2008, nr.28, dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, nr.08/L-185, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, më qellim të hartimit të draft strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

Për formimin e grupit punues për hartimin e draft strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje

- 1. CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e Draft Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1.** Binak Sylaj, Drejtorja e Administratës, kryesues;
 - 1.2.** Agron Bacaj, Drejtorja e Shëndetësisë dhe MS, anëtarë;
 - 1.3.** Drilon Morina, zyrtar përgjegjës për të drejtat e njeriut, anëtarë;
 - 1.4.** Vitore Shala, zyrtare për barazi gjinore, anëtarë;
 - 1.5.** Astrit Muhaxheri, zyrtar përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, anëtare;
 - 1.6.** Driton Raci, zyra ligjore, anëtarë;
 - 1.7.** Ahmet Berisha, zyra për pune të kuvendit, anëtarë;
 - 1.8.** Vlora Tafili, zyra për informim, anëtarë;
 - 1.9.** Kristina Lazri, DKRS, anëtare;
 - 1.10.** Shehrije Millaku, QPS, anëtare si dhe;
 - 1.11.** Adnan Zeneli, zyrtar përgjegjës për mbrojtje nga diskriminimi, anëtarë.
- 2.** Grupi punues është përgjegjës për hartimin e drafteve të përmendura si në piken 1 të këtij vendimi, marrjen e propozimeve dhe komenteve gjatë diskutimeve publike si dhe vendosjen lidhur me inkuorporimin e tyre në dokumente.
- 3.** Me rastin e përgatitjes së drafteve finale dhe kryerjes së procedurave të konsultimeve publike, njoftohet kryetari i komunës më qellim të procedimit të tyre për shqyrtim dhe miratim pran Kuvendit të Komunës.
- 4.** Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Ekzekutivi;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Elezaj

